



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 286/5 prot.

Tiranë, më 11.8.2020

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 269, datë 1.7.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Valdete Hoxha
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F i aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 27.7.2020 është njoftuar vendimi nr. 269, datë 1.7.2020, për subjektin e rivlerësimit znj. Valdete Hoxha, gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Darjel Sina ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 269, datë 1.7.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Valdete Hoxha, ushtron detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, dhe, në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës dhe nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin znj. Valdete Hoxha ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kritereve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i

Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim referuar si KLGJ), nga të cilat rezulton se:

2.1 **ILDKPKI**, bazuar në nenin 33, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin znj. Valdete Hoxha*”, ka referuar se:

- i. *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii. *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- iii. *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- iv. *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- v. *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 **DSIK**, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës, ka referuar: “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës*” për subjektin e rivlerësimit.

2.3 **KLGJ**, bazuar në nenin 43, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, nëpërmjet rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara dhe të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, si dhe rishikimit të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi rastësor, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për analizimin e aftësive profesionale.

3. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

3.1 *Për vlerësimin e pasurisë.* Referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, nga hetimi administrativ dhe kontrolli financiar-ligjor për pasuritë e paluajtshme, të luajtshme, të ardhurat, shpenzimet dhe likuiditetet për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur dhe të tjerë të lidhur me të, Komisioni, ndër të tjera, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në Deklaratën “*Vetting*” pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D, të aneksit të Kushtetutës. Subjekti ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj. Për sa më sipër, trupi gjykues ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Valdete Hoxha, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

3.2 *Për kontrollin e figurës.* Referuar nenit DH, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi ka administruar raportin mbi verifikimin e figurës, i cili konfirmon përshtatshmërinë e subjektit për vijimin e detyrës, informacioneve nga agjencitë ligjzbatuese dhe pasi ka kryer hetimin administrativ për këtë qëllim, ka vlerësuar se nuk janë gjetur elemente që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit dhe se ka arritur një nivel të besueshëm sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

3.3 *Për vlerësimin e aftësive profesionale.* Referuar nenit E, të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44, të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreut II, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, të ndryshuar, Komisioni, pasi ka administruar raportin e përgatitur nga KLGJ, rekomandimin e relatorit të çështjes, hetimin dhe vlerësimin e (34) denoncimeve nga publiku, në përfundim ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është efiçente dhe efektive në masë të pranueshme, duke arritur nivel kualifikues sipas parashikimit të germës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

4. Vendimi i Komisionit. Bazuar në përfundimet e mësipërme, trupi gjykues i Komisionit ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit, znj. Hoxha, ka plotësuar së bashku kushtet e parashikuara nga neni 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, duke arritur një nivel të besueshëm vlerësimi për të tri kriteret, e për këto arsye, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur (ndër të tjera, si pjesë e dispozitivit):

- Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Valdete Hoxha, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

II. Shkaqet e ankimit

5. Në kuptim të nenit 179/b, të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet që kryejnë procesin e rivlerësimit kalimtar (Vetting).

6. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

7. Në krahasim me kompetencat e njohura për Komisionin dhe Kolegjin nga neni Ç, i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48 - 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit ta mbështesë vetëm në vlerësimin e akteve dhe provave të administruara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni.

8. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, në gjendjen që janë aktet, duke vlerësuar nëse vendimmarrja është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave të administruara.

9. Në vështrim të sa më sipër, Komisioneri Publik, pasi shqyrtoi vendimin nr. 269, datë 1.7.2020, konstaton se përfundimet e arritura nga Komisioni për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Hoxha, janë rrjedhojë e një vlerësimi jo të drejtë të provave si dhe një hetimi jo të plotë dhe shterues administrativ. Vetëm në këtë mënyrë, faktet dhe rrethanat e dala nga aktet e administruara, bazuar edhe në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve, objektivisht do të justifikonin arritjen e nivelit të besueshmërisë sipas nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016.

10. Komisioneri Publik, në konsideratë të mangësive të konstatuara, vlerëson se vendimi objekt ankimi është i cenueshëm dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Në këto kushte, nëpërmjet këtij mjete procedural (ankimit), në respektim të kërkesave kushtetuese e ligjore për rivlerësimin kalimtar të subjekteve dhe në mbrojtje të interesit publik, kërkojmë rishikimin e vendimit nr. 269, datë 1.7.2020, të Komisionit nga ana e Kolegjit, lidhur me nevojën e hetimit të mëtejshëm të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, personave të lidhur dhe të tjerë të lidhur me të, administrimit të provave të nevojshme në vlerësimin e aftësisë dhe mjaftueshmërisë financiare dhe mënyrën e krijimit të pasurisë/likuiditeteve, si dhe shpenzimeve të deklaruara dhe ato të rezultuara nga hetimi administrativ, me qëllim justifikimin bindshëm të burimit të krijimit, sipas kërkesave të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

11. Komisioneri Publik, në vijimësi të qëndrimeve të mbajtura nga ky institucion në ushtrimin e ankimeve, nëpërmjet të cilave kërkohet hetimi i mëtejshëm i kriterëve të rivlerësimit, vlerëson se edhe kontrolli i figurës dhe ai profesional i subjektit, bazuar në nenin DH dhe E të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, të jenë pjesë e shqyrtimit gjyqësor ana e Kolegjit, me qëllim arritjen në një vendimmarrje përfundimtare për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve të rivlerësimit.

12. Për sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës si dhe nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 269, datë 1.7.2020, të Komisionit, ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit.

II. A Analiza e shkaqeve të ankimit

13. Për vlerësimin e kriterit të pasurisë, mbështetur dhe në jurisprudencën e Kolegjit, Komisioneri Publik mban në konsideratë faktin se saktësia dhe mjaftueshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe shpjegimi bindshëm i burimit të ligjshëm të pasurisë në pronësi apo në përdorim të tij dhe të personave të lidhur, janë elemente thelbësore dhe përcaktuese në kontrollin e këtij kriteri.

14. Në nenin D të aneksit të Kushtetutës parashikohet se subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë, në përputhje me ligjin. Në vijim të këtij përcaktimi kushtetues, ligji nr. 84/2016, në nenin 32, ka parashikuar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Ndërsa në pikën 4 të këtij neni, lidhur me marrëdhëniet juridike të konfirmuara të huas dhe të dhurimit, parashikohet se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ose personat e tjerë të lidhur, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

15. Komisioneri Publik, në vlerësim të kriterit të pasurisë, është bazuar në aktet e administruara dhe rrethanat e çështjes, të cilat në gjendjen që janë paraqesin nevojën për riçeljen e hetimit gjyqësor, pasi konstatojmë se hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk ka qenë i gjithanshëm, i plotë dhe shterues në lidhje me mjaftueshmërinë dhe aftësinë huadhënëse të personit tjetër të lidhur, znj.***.*** (kunata e subjektit), për justifikimin bindshëm të huas së dhënë vajzës së subjektit të rivlerësimit, znj.***.***, person i lidhur, në

shumën totale prej 93.952,08 CAD (Dollar kanadez), për të mbuluar shpenzimet e studimit në Kanada gjatë viteve 2012-2016 dhe dhurimet në shumën totale 11.500 CAD.

16. Nisur nga rrethanat e faktit të kësaj marrëdhënie huaje dhe dhurimi, detyrimi i parashikuar nga neni 32, pika 1 dhe 4, të ligjit nr. 84/2016, shtrihet mbi të ardhurat e personave të tjerë të lidhur që rezultojnë si huadhënës apo dhurues në favor të vajzës dhe bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Kjo marrëdhënie juridike e deklaruar dhe e pranuar nga subjekti i rivlerësimit dhe vajza e saj, në cilësinë e personit të lidhur me të, plotësojnë kushtet e përcaktuara nga ligji për t'u cilësuar marrëdhënie me interes pasuror me subjektin e rivlerësimit, referuar nenit 3/14 dhe 32/4, të ligjit nr. 84/2016.

17. Për sa më sipër, Komisioni ka administruar provat e vëna në dispozicion nga ana e subjektit të rivlerësimit, të cilat në gjendjen që janë, në harmoni me indiciet që dalin prej tyre, në vlerësimin e Komisionerit Publik, e bëjnë të nevojshme hetimin e mëtejshëm, në funksion të besueshmërisë dhe provueshmërisë bindshëm të mundësisë financiare dhe burimit të ligjshëm të huas dhe dhurimit.

18. Në analizë ligjore të këtij shkakui ankimi, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit¹, Komisioneri Publik mban në konsideratë kufijtë proporcionalë të këtij kontrolli pasuror për personat e lidhur dhe të tjerë të lidhur dhe raportin përpjestimor që duhet të ketë ky kontroll me barrën e provës të subjektit të rivlerësimit, në justifikimin e pasurisë objekt huaje apo dhurimi. Sikurse edhe Kolegji ka mbajtur qëndrim në raste të ngjashme, pjesë e këtij vlerësimi duhet të jenë si të ardhurat (në çdo rast, të ligjshme sipas nenit D të aneksit të Kushtetutës) dhe shpenzimet e realizuara nga personi i lidhur apo tjetër i lidhur, i deklaruar në cilësinë e huadhënësit apo dhuruesit, sipas një vlerësimi logjik e të arsyeshëm, rast pas rasti dhe sipas rrethanave specifike të tyre, përveç atyre rasteve kur ekzistojnë dyshime për pasuri të fshehura në emër të personave të tjerë të lidhur.

19. Për rastin objekt ankimi, Komisioneri Publik e çmon të nevojshme vlerësimin e mëtejshëm të disa rrethanave dhe fakteve të rezultuara nga aktet e administruara në drejtim të shpenzimeve të kryera nga huadhënësit, familja ***, në cilësinë e personave të tjerë të lidhur. Ky kontroll nuk synon vlerësimin e burimit të ligjshëm të çdo pasurie të vënë nga këta persona, por vlerësimin e shpenzimeve të tyre (përfshirë dhe ato në vënien e pasurisë) në raport me mundësinë dhe mjaftueshmërinë financiare për të dhënë hua shumën 93.952,08 CAD, vajzës së subjektit të rivlerësimit dhe dhurimet e deklaruara. Kështu, nga verifikimi i akteve në dosjen e Komisionit, rezulton se marrëdhënia e huas dhe dhurimi ndër vite është deklaruar si vijon:

19.1 Në *Deklaratën "Vetting"* (në vijim referuar si D-Vett.), në rubrikën "Të dhëna konfidenciale" subjekti ka deklaruar: "...Vajza ka ndjekur studimet e larta pranë Universitetit të Albertës në Kanada, që prej vitit 2012. Ka jetuar te halla e saj, ***.***, me nënshtetësi kanadeze, e cila i ka huazuar shpenzimet e shkollimit, siç ka deklaruar në deklaratën e interesave private të vajzës. Që nga muaji maj 2016 ka filluar punë dhe gjithashtu ka filluar shlyerjen e detyrimeve ndaj hallës së saj".

19.2 Në të njëjtën deklaratë, në rubrikën "Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë", personi i lidhur, vajza e subjektit të rivlerësimit, znj.***.***, ka deklaruar: "Hua për

¹ Për më tepër, shih vendimin (JR) nr. 8/2019, nr. 9/2019, nr. 14/2019, nr. 15/2019, nr. 20/2019, nr. 26/2019, nr. 28/2019, nr. 4/2020 etj., të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

arsimim pranë Universitetit të Albertës, gjatë periudhës shtator 2012 – prill 2016. Fillimi i shlyerjes së huasë është me fillimin e punës (data e fillimit të punës është ***.5.2016). Kësti mujor është jo më pak se 10% e të ardhurave mujore dhe me kohëzgjatje deri në shlyerjen e plotë. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e **pashlyer** është në vlerën 81.600 CAD... Burim i origjinës së huas janë të ardhurat e punës së saj”.

19.3 Në DV-2010, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale, dhurata dhe trajtime preferenciale”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shumën 2.000 CAD, dhurim nga kunata, znj.***.***.

19.4 Në DV-2011, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale, dhurata dhe trajtime preferenciale”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shumën 3.000 CAD, dhurim nga kunata, znj.***.***.

19.5 Në DV-2012, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale, dhurata dhe trajtime preferenciale”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shumën 2.970,76 CAD, dhurim nga kunata, znj.***.***. Në të njëjtën deklaratë, në rubrikën “Ndryshimet e pasurisë dhe burimi i krijimit”, personi i lidhur, vajza e subjektit, znj.***.***, ka deklaruar: “Dhuratë nga halla në shumën 3.500 CAD, në shtator 2012”. Po ashtu, në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, znj.***.*** ka deklaruar: “Huamarrje në shumën 11.487,92 CAD, nga halla, znj.***.***, nga muaji shtator 2012, për ndjekjen e studimeve pranë Universitetit Alberta, Edmonton Kanada”.

19.6 Në DV-2013, në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, personi i lidhur, znj.***.***, ka deklaruar: “Huamarrje në shumën 13.727,27 CAD, nga halla, znj.***.***, nga muaji janar 2013, për ndjekjen e studimeve pranë Universitetit Alberta, Edmonton Kanada”.

19.7 Në DV-2014, në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, personi i lidhur, znj.***.***, ka deklaruar: “Huamarrje në shumën 28.405 CAD, nga halla, znj.***.***, nga muaji janar 2014, për ndjekjen e studimeve pranë Universitetit Alberta, Edmonton Kanada”.

19.8 Në DV-2015, në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, personi i lidhur, znj.***.***, ka deklaruar: “Huamarrje në shumën 27.577,35 CAD, nga halla, znj.***.***, nga muaji janar 2015, për ndjekjen e studimeve pranë Universitetit Alberta, Edmonton Kanada”.

19.9 Në DV-2016, në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, personi i lidhur, znj.***.***, ka deklaruar: “Huamarrje në shumën 12.754,14 CAD, nga halla, znj.***.***, për periudhën janar - prill 2016, për ndjekjen e studimeve pranë Universitetit Alberta, Edmonton Kanada”. Në të njëjtën rubrikë deklarohet shlyerja e huas në shumën 13.775,48 CAD deri në 31 dhjetor të vitit 2016, ndërsa gjendja e detyrimit të mbetur pa shlyer deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit është në vlerën 68.845,86 CAD.

19.10 Për sa më sipër, për vitet 2010-2016, rezulton se personat e lidhur me subjektin e rivlerësimit (bashkëshorti dhe vajza) kanë përfituar shumën (i) rreth 11.500 CAD, në formën e dhurimit dhe (ii) 93.952,08 CAD, si shpenzime studimesh, të dhëna nga personi tjetër i lidhur, znj.***.***. Një fakt i tillë konfirmohet edhe nga përgjigjet e subjektit, në pyetësin

e datës 4.3.2019, ku pohon se: “Ajo dhe bashkëshorti i saj nuk kanë bërë pagesa për shkollimin e vajzës së saj, ***,***,***, pranë Universitetit Alberta”.

19.11 Ndërkohë, nga verifikimi i llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit, të përcjella nga bankat e nivelit të dytë² në Shqipëri, rezulton se, pasi subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë paguar apartamentin në shumën 2.000.000 lekë, ka filluar të krijojë kursime/depozita në bankë, të cilat në vitin 2012 janë në shumën rreth 3.000.000 lekë dhe në vitet në vijim janë shtuar, duke arritur shumën 4.000.000 lekë³ në vitin 2016.

19.12 Gjithashtu, në përgjigjet e pyetësorit datë 4.3.2019, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se shpenzimet jetike për vajzën e saj për vitet e studimit 2012 - 2016 janë përballuar nga familja ***,***,***, dhe nga të ardhurat e vajzës nga puna *part-time*. Krahas kësaj, në deklaratat e interesave private periodike vjetore nga DV-2010 deri në DV-2016, personi i lidhur, znj.***,***, ka deklaruar si adresë banimi të njëjtën adresë me shtëpinë e hallës së saj në Kanada, ***,***,***, Street, Edmonton, Alberta.

19.13 Pra, nëse huas financiare për mbulimin e shpenzimeve të studimit do t'i shtohet dhe kjo mbështetje jo financiare nga ana e familjes ***,***,***, kontributi i kësaj të fundit për shpenzimet e studimit dhe jetesës së vajzës së subjektit do të ishte një vlerë edhe më e madhe⁴.

19.14 Për rrethanat faktike si më sipër, në referencë të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni ka kryer analizën financiare për familjen ***,***,***, për periudhën 2010-2016⁵ dhe ka konkluduar: “... se motra e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit ka patur të ardhura të mjaftueshme për të dhuruar shumën 11.500 CAD..., për të dhënë huatë dhe për të mbuluar shpenzimet e jetesës së vajzës së subjektit gjatë studimeve të saj”.

20. Komisioneri Publik, bazuar në aktet e administruara në dosje të Komisionit, lidhur me aftësinë financiare të personit tjetër të lidhur, znj.***,***, konstaton se:

20.1 Në përgjigjet e pyetësorit datë 23.4.2020, subjekti ka deklaruar se: **(i)** huadhënësja znj.***,***, së bashku me familjen e saj, në datën ***,***,***,11.2002 është larguar për në Kanada dhe aktualisht jetojnë në banesën e blerë nëpërmjet kredisë bankare, me adresë: ***,***,***, Street, Edmonton, Alberta Kanada. **(ii)** Në vitin 2010, familja ***,***,***, ka blerë një apartament në adresën: Rruga “***,***”, Tiranë, me sipërfaqe 106.63 m², me vlerë 75.000 euro dhe ka paguar 95% të vlerës së apartamentit sipas Aktmarrëveshjes nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***,***,***,7.2010. Diferencën e çmimit prej 3.785 euro e ka paguar me lidhjen e kontratës së shitblerjes nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***,***,***,8.2012. **(iii)** Gjithashtu, në vitin 2016 familja ***,***,***, ka blerë në Shqipëri automjetin Mercedes Benz, në vlerën 6.000 euro, sipas kontratës së shitjes nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***,***,***,8.2016.

20.2 Ndërkohë që për apartamentin në Shqipëri subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin përkatës, për investimin e kryer për shtëpinë nga familja ***,***,***, në Kanada nuk rezulton të jetë hetuar vlera totale e këtij investimi dhe viti i investimit sipas dokumentacionit të fitimit të pasurisë.

² Shkresa e ***,***,***,B nr. *** prot., datë ***,***,***,2.2019, shkresa e ***,***,***, Bank nr. *** prot., datë ***,***,***,3.2019.

³ Dy depozita në ***,***,***,B, ku subjekti është titullare e llogarisë dhe një depozitë bashkëemërore në emër të subjektit dhe bashkëshortit të saj.

⁴ Hua e marrë në vlerën 93.952 CAD. Bazuar në <https://www.150.statcan.gc.ca> shpenzimet e jetesës së vajzës për vitet 2012-2016 janë rreth 50.000 CAD.

⁵ Për më tepër referohuni në analizën financiare f. 17 të vendimit të Komisionit.

20.3 Në lidhje me investimin për shtëpinë në Kanada, duke qenë se gjatë hetimit subjekti ka deklaruar si burim financimi kredi bankare nga banka në Kanada, nga aktet e administruara mbetet e paqartë: (i) nëse vlera totale e këtij aseti është financiar tërësisht nga kredia bankare apo janë përdorur dhe kursimet e familjes *** për të mbuluar shumën e paguar; (ii) viti i marrjes së kredisë dhe kohëzgjatja e saj, si dhe (iii) data e fillimit të shlyerjes së kredisë dhe kësti mujor i pagesës së kredisë.

20.4 Nga dokumentacioni bankar i administruar gjatë hetimit administrativ, depozituar nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit datë 23.4.2020, për apartamentin në Tiranë, rezulton se nga *** Bank Albania janë kryer pagesat për blerje shtëpie,⁶ të urdhëruara nga llogaria e z.***.***, me përfitues shoqërinë ndërtuese “****” sh.p.k.

20.5 Nga ky fakt, vijmë në dijeni që familja ***, edhe pse nuk jeton në Shqipëri nga viti 2002, në vitin 2010 vazhdon të ketë llogari bankare në *** Bank në Shqipëri, më së paku në vlerën 71.921,9 euro, që është përdorur për shlyerjen e pagesës së apartamentit në Tiranë. Rezulton se për qëllim të vlerësimit të aftësisë financiare huadhënëse dhe të dhurimit, Komisioni nuk ka administruar lëvizjet e llogarive bankare të personave të tjerë të lidhur (familjes ***) në Shqipëri dhe Kanada.

20.6 Duke përfunduar për sa më sipër, Komisioneri Publik rithekson edhe njëherë faktin se nëpërmjet këtij ankimi, ndër të tjera, synohet që shqyrtimi gjyqësor në Kolegj të vlerësojë faktet dhe indiciet e rezultuara nga aktet e administruara, në drejtim të shpenzimeve dhe kursimeve të familjes ***, në raport logjik me huanë dhe dhurimin në favor të personave të lidhur me subjektin e rivlerësimit. Ky kërkim bëhet me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve që kanë lidhje me rrethanat e çështjes, në drejtim të vlerësimit të kriterit të pasurisë apo të vlerësimit të përgjithshëm të të tria kriterëve, sipas përcaktimit të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

20.7 Vlerësimi i këtyre rrethanave merr rëndësi në rastin konkret, pasi eventualisht ato do të ndikonin në vlerësimin e mjaftueshmërisë dhe burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë dhe shpenzimeve të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, në kuptim të nenit 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016.

21. Për sa i përket çështjeve të hetuara dhe për të cilat subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime, bazuar mbi të njëjtat prova të administruara, Komisioneri Publik ndan gjykim të ndryshëm me përfundimet e arritura nga Komisioni në lidhje me: (i) shlyerjen e huas në shumën 13.775,48 CAD në vitin 2016, nga personi i lidhur znj.***.***, kundrejt personit tjetër të lidhur, znj.***.*** dhe (ii) pagesën e shumës 7.000 euro për blerjen e makinës Ford Focus, në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj.

22. Lidhur me shlyerjen e huas në vitin 2016, në DV-2016, në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, personi i lidhur, znj.***.***, ka deklaruar: shlyerja e huas në shumën 13.775,48 CAD deri në 31 dhjetor të vitit 2016. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorit të datës 4.3.2019, ndër të tjera, ka deklaruar

⁶ Njoftime debitimi nga ***B për shumën: (i) 1.000 euro, paguar në datën ***.7.2010, me përshkrimin: “Pagesë për blerje shtëpie, kësti I”; (ii) shumën 70.000 euro në datën ***.7.2010, me përshkrimin: “Likuidim blerje shtëpie sipas Aktmarrëveshjes nr.*** rep. dhe nr.*** kol., datë ***.7.2010, blerësi *** dhe ***.***”; (iii) 921.9 euro, paguar në datën ***.7.2010, me përshkrimin: “Lik. Dif. Blerje shtëpie ...”; (iv) 3.785.36 euro, paguar në datën ***.7.2012, me përshkrimin: “Pagesë për blerje shtëpie, ***.***, kësti i fundit”.

se: "... vajza ***.*** ka shpenzuar për vitin 2016 shumën 13.775,48 CAD, për shlyerjen e huas për studime, marrë nga halla e saj, znj.***.***. Lidhur me mënyrën e pagesës ka sqaruar se kjo shumë nuk është shlyer e gjitha përnjëherë, por me këste mujore”.

22.1 Në dosjen e Komisionit janë administruar me cilësinë e provës edhe lëvizjet e llogarive bankare të vajzës së subjektit të rivlerësimit, znj.***.***, nga banka kanadeze “***.***.***”. Nga verifikimi i lëvizjeve të këtyre llogarive bankare, ndryshe nga sa deklarohet në DV-2016, nuk rezulton që personi i lidhur, znj.***.***, gjatë vitit 2016 të ketë kryer pagesa nga llogaria e saj në favor të personit tjetër të lidhur, znj.***.***.

22.2 Marrë në konsideratë së bashku, faktet se: (i) të ardhurat e realizuara nga znj.***.*** gjatë vitit 2016 janë rreth 53.000 CAD, (ii) kursimet (gjendje) në llogaritë bankare janë rreth 27.000 CAD dhe diferenca e mbetur ka shërbyer për shpenzime/pagesa të kryera nëpërmjet llogarisë së saj bankare, na rezulton se personi i lidhur, vajza e subjektit të rivlerësimit, ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, pasi për vitin 2016 rezulton se ka qenë në pamundësi financiare për të shlyer huanë ndaj znj.***.***, në shumën 13,775.48 CAD.

22.3 Lidhur me gjendjen e detyrimit të mbetur pa shlyer kundrejt znj.***.***, në D-Vett. dhe në deklaratat periodike vjetore, personi i lidhur, znj.***.***, ka deklaruar si vijon:

- Në D-Vett., dorëzuar në ILDKPKI, në datën 26.1.2017, deklarohet: Shuma e detyrimit financiar të mbetur pa shlyer në vlerën 81.600 CAD.
- Në DV-2016 deklarohet: Gjendja e detyrimit e mbetur pa shlyer deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit, 68.845,86 CAD. Detyrim i mbetur për të shlyer i huas për shkollimin pranë Universitetit të Albertës për vitet 2012-2016.
- Në DV-2017 deklarohet: Gjendja e detyrimit të mbetur pa shlyer deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit, 59.245,86 CAD.

22.4 Bazuar në sa më sipër deklaruar, konstatojmë se: (i) nuk përputhet gjendja e detyrimit të deklaruar në Deklaratën “Vetting” me atë të deklaruar në DV-2016, (ii) referuar gjendjes së detyrimit të mbetur të pa shlyer në DV -2016⁷ dhe DV- 2017⁸, rezulton që deri në fund të vitit 2017 të jenë shlyer 34.706,22 CAD, nga të cilat 9.600 gjatë vitit 2017, dhe diferenca që llogaritet në vlerën 25.106,22 CAD, të jetë shlyer deri në fund të vitit 2016. Ndërkohë personi i lidhur, vajza e subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar se gjatë vitit 2016 është shlyer shuma 13.775,48 CAD. I njëjti deklarim është konfirmuar edhe nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ të Komisionit.

22.5 Sa më sipër, mbetet e paqartë sa është shuma e detyrimit të shlyer nga personi i lidhur, znj.***.***, kundrejt personit tjetër të lidhur, huadhënëses znj.***.***, deri në datën 31.12.2016.

⁷ Detyrimi në total në vlerën 93.952,08 CAD – detyrimi i mbetur pa shlyer në fund të vitit 2016 në vlerën 68.845,86 CAD = detyrimi i shlyer 25.106,22 CAD.

⁸ Detyrimi në total në vlerën 93.952,08 CAD – detyrimi i mbetur pa shlyer në fund të vitit 2017 në vlerën 59.245,86 CAD – 9,600 CAD (të deklaruara si të paguara gjatë vitit 2017) = detyrimi i shlyer deri në fund të vitit 2016 është në vlerën 25,106.22 CAD.

22.6 Na rezulton gjithashtu, se në Deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar dhurimin e bërë nga znj.***.***, në shumën 3.500 CAD, në favor të vajzës së saj si dhe dhurimin në shumën 2.970,76 CAD, në favor të bashkëshortit të subjektit, në vitin 2012.

23. Lidhur me pagesën e shumës 7.000 euro për blerjen e makinës Ford Focus, në pronësi të subjektit dhe bashkëshortit të saj

23.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Autoveturë Ford Focus, viti i prodhimit 2011, me targë: AA***, financuar sipas kontratës së qirasë financiare nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.7.2011, nga shoqëria “****” sh.a., për vlerën 14.000 euro. Referuar pagesës 7.000 euro, janë paguar nga kursimet e të ardhurave dhe 7.000 euro me qira, me interes 8% dhe afat shlyerje katër vjet. Vlera 14.000 euro, pjesa takuese 50% në bashkëpronësi me bashkëshortin.

23.2 Në DV-2011, subjekti ka deklaruar se: “Me kontratën e qirasë financiare Leasing nr.*** rep., nr. *** kol., datë ***.7.2014, është blerë makinë tip Ford Focus (në bashkëpronësi), nga shoqëria “****”, për vlerën 14.000 euro, nga të cilat 7.000 euro janë paguar në momentin e lidhjes së kontratës dhe 7.000 euro do të paguhet për katër vjet”.

23.3 Në dosjen e Komisionit janë administruar: Kontratë e qirasë financiare nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.7.2011, nga shoqëria “****” sh.a., nëpërmjet së cilës subjekti dhe bashkëshorti i saj marrin me qira financiare automjetin tip Ford, në vlerën 14.000 euro. Kontratë shitje me shoqërinë “***.***.***” sh.p.k., datë ***.7.2011, e subjektit dhe bashkëshortit të saj, z.***.***, në cilësinë e blerësit për blerjen e automjetit tip Ford Focus, në vlerën 14.000 euro.

23.4 Mbi mënyrën e pagesës, parashikohet se 7.000 euro është bërë parapagim në momentin e nënshkrimit të kontratës, ndërsa pjesa e mbetur, 7.000 euro, do të paguhet para marrjes së automjetit në dorëzim. Nga mandatpagesa, e lëshuar nga *** Bank sh.a., rezulton të jetë depozituar *cash* në *** Bank, në datën ***.7.2011, shuma 7.000 euro me përshkrim veprimi: “***.*** dhe Valdete Hoxha, parapagesë këst leasing”.

23.5 Mbi mundësinë e subjektit për të kryer pagesën prej 7.000 euro, Komisioni ka kryer analizën financiare deri në fund të vitit 2011 dhe ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka patur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie dhe deklarimi i subjektit përputhet me të dhënat e administruara.

24. Komisioneri Publik, në analizë të mjaftueshmërisë financiare nga burime të ligjshme të pagesës në shumën 7.000 euro, datë 19.7.2011, ka analizuar të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për periudhën 1.1.2011 – 19.7.2011, si më poshtë:

24.1 Nga verifikimi i llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit pranë bankave të nivelit të dytë, për periudhën 1.1.2011-19.7.2011, edhe nëse marrim në konsideratë shumën prej 2.971 CAD, të dhuruar nga znj.***.***⁹, tërheqja nga banka e së cilës përkon me datën e pagesës së këstit, rezulton se subjekti dhe bashkëshorti kanë tërhequr *cash* nga llogaritë e tyre bankare në total shumën 917.260 lekë¹⁰. Ndërsa pagesa për

⁹ Nga aktet në dosje nuk rezulton të jenë paguar detyrimet tatimore në kuptim të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, lidhur me këtë shumë të dhuruar.

¹⁰ Rezulton të jenë tërhequr *cash* 353.000 lekë nga llogaria e bashkëshortit të subjektit, 260.000 lekë nga llogaria e subjektit, si dhe ekuivalenti i shumës 2.971 CAD, të dhuruara nga znj.***.***, që me kursin e BSH-së, së datës 19.7.2011, llogariten në vlerën 304.260 lekë.

automjetin dhe shpenzimet e tjera llogariten në shumën 1.304.351 lekë¹¹. Si rezultat subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk mbulojnë me burime të ligjshme pagesën në shumën 7.000 euro, për një diferencë negative më së paku prej -387.091 lekë.

24.2 Vlen të theksojmë se, në analizën e mësipërme financiare, nuk janë përfshirë shpenzime për një udhëtim të kryer nga vajza e subjektit të rivlerësimit në periudhën 10.7.2011-12.8.2011. Për këtë udhëtim, Komisioni ka llogaritur një kosto prej 47.714 lekësh, ndërkohë që nuk rezulton që gjatë hetimit administrativ subjekti i rivlerësimit të jetë pyetur dhe të ketë dhënë shpjegime lidhur me destinacionin dhe mbulimin e kostove të këtij udhëtimi. Nëse shpenzimi për këtë udhëtim do të llogaritej bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, shpenzimi për këtë udhëtim do të rezultonte më i lartë se shpenzimi i llogaritur nga Komisioni dhe do të thellonte diferencën negative të konstatuar lidhur me pagesën në shumën 7.000 euro.

III. Kërkimi i ankimit

25. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshën për konfirmimin e saj në detyrë;

26. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

27. Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, DH, E dhe F të aneksit të Kushtetutës, neneve 4, 30-34, 40-44, pikës 3, 4 dhe 5 të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016;

28. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë në mënyrë alternative:

- Ndryshimin e vendimit nr. 269, datë 1.7.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

ose

- Lënien në fuqi të këtij vendimi.

KOMISIONERI PUBLIK

Darjel SINA

¹¹ Ekulivalenti i pagesës 7.000 euro me kursin e BSH- së së datës kur është kryer pagesa llogaritet në vlerën 972.230 lekë, shpenzimet e jetesës janë llogaritur në shumën 296.010 lekë (546.480/12*6.5), ndërsa shpenzimet e shkollimit të djalit në shumën 36.111 lekë (65.000/9*5).